



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME
RASTIN E DYVJETORIT TË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 17 SHKURT 2010**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA POVODOM
DVOGODIŠNJICE NEZAVISNOSTI REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 17.
FEBRUARA 2010. GODINE**

**SHKURT – FEBRUAR
2010**

T R A N S K R I P T

I SEANCËS SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME RASTIN E DYVJETORIT TË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 17 SHKURT 2010

E mërkurë, 17 shkurt 2010, ora 14,00

Seancën solemne e drejtoi dr. Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT, JAKUP KRASNIQI:

Të nderuar të pranishëm,

Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e shënimit të dyvjetorit të pavarësisë së Kosovës.

(Intonimi i Himnit të Republikës së Kosovës)

(Duartrokitje)

I nderuar president Sejdiu,

I nderuar kryeministër Thaçi

I nderuar kryesues i ICO-s, zoti Peter Feith,

Ministër i Republikës së Shqipërisë, Xhaferi,

Kongresist Pomeroy,

Të nderuar përfaqësues diplomatikë,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë e bashkëkombës, kudo që jeni,

Zonja dhe zotërinj,

Sot na bashkon dyvjetori i Pavarësisë së Kosovës. Dy vite janë pak për historinë, por kthesa që ka bërë Kosova gjatë dhjetë viteve të lirisë dhe dy viteve të pavarësisë është e madhe dhe historike. Kosova e popullit prej më të vjetërve të Evropës, ishte e humbur dhe e harruar dikur në hartën e zhubravitur të Ballkanit të konflikteve të përgjakshme. U deshën përpjekje e sakrifica të shumë brezave për ta bërë Kosovën shtet të pavarur, sovran e demokratik, të njohur e të respektuar në katër anët e botës.

Në dy vitet e shtetndërtimit Kosova i ka ngritur të gjitha institucionet kushtetuese e demokratike të shtetit, e ka stabilizuar shoqërinë shumetnike dhe është bërë faktor paqeje në rajon.

Në këtë sallë, gjatë dy legjislatrave të kaluara janë miratuar mbi 160 ligje, ndërsa vetëm gjatë këtyre dy viteve të pavarësisë janë miratuar mbi 140 ligje, të cilat rregullojnë shtetësinë e Kosovës, përcaktojnë standarde të larta të mbrojtjes së të drejtave të

minoriteteve dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut, mundësojnë zhvillimin e gjithanshëm të vendit dhe hapin perspektivën integruese në Bashkimin Evropian dhe në institucionet tjera euroatlantike.

Kosova tashmë është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, e Bankës Botërore, pjesëmarrëse në organizma, forume e iniciativa rajonale e ndërkombëtare dhe në rrugë të mirë për të hyrë në familjen e madhe të Kombeve të Bashkuara.

Pas mbrojtjes së shkëlqyer të së drejtës dhe të legjitimitetit të shpalljes së pavarësisë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe pas shpalljes së mendimit të saj këshillëdhënës, presim që shpejt të shtohet numri i vendeve anëtare të OKB-së që do ta njohin pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Pavarësia ishte një nga parakushtet e domosdoshme të zhvillimit të përgjithshëm të Kosovës. Kosova ka potenciale të shumta zhvillimi e përparimi, por nuk i mungon as mbështetja e solidariteti ndërkombëtar. Prezenca ndërkombëtare, civile dhe ajo e sigurisë, angazhimi i miqve tanë të shumtë për forcimin e vendit tonë dhe Konferenca e donatorëve e vitit 2008, e konfirmojnë përkushtimin e bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën dhe popullin e saj.

Zhvillimi ekonomik ka shënuar rritje vjetore rreth 4%, që në këtë kohë krize globale për Republikën e Kosovës është shumë domethënëse. Janë krijuar kushte të favorshme për investime të kapitalit të huaj në Kosovë, siç janë: siguria e stabiliteti politik, infrastruktura ligjore e fizike, telekomunikimet dhe lehtësitë doganore e tatimore, siguri i një mjedisi të qëndrueshëm biznesi, të cilat bashkë me pasuritë e mëdha dhe potencialin rinor e fuqinë e lirë punëtore, do të tërheqin investime të huaja dhe do të mundësojnë zhvillim të shpejtë. Viti 2010 do të shënojë kthesë të rëndësishme në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Por, me gjithë trendin pozitiv, ekonomia jonë ende ndodhet në fazat e para të zhvillimit të saj. Ekonomia e Kosovës aktualisht karakterizohet me një normë të lartë të papunësisë, është kryesisht ekonomi konsumuese me nivel të lartë të importeve dhe nivel të ulët të eksporteve. Për shkak të së kaluarës do të duhen edhe shumë përpjekje për të tejkaluar prapambetjen e Kosovës, varfërinë dhe papunësinë e lartë.

Në nëntorin e kaluar, Kosova mbajti zgjedhjet e para pas pavarësisë, të organizuara për herë të parë nga institucionet e vendit, të cilat u vlerësuan lart nga vëzhguesit dhe institucionet relevante ndërkombëtare. Pjesëmarrja e shtuar e komuniteteve pakicë dhe sidomos e komunitetit serb në këto zgjedhje, është tregues i qartë i realitetit të ri integruar në Kosovë. Kushdo mund të shohë vullnetin e të gjithë qytetarëve të Kosovës për integrim dhe bashkëjetesë, por është ndërhyrja obstruktive dhe ndikimi agresiv i Beogradit që e vështirësojnë këtë proces të interesit tonë të përbashkët. Republika e Kosovës, më mirë se çdo vend tjetër i rajonit aplikon politikën e të drejtave të avancuara për komunitetet pakicë, të diversitetit etnik, gjuhësor e kulturor, të cilën do të dëshironim ta shihnim edhe te fqinjët tanë.

Në vijim të përpjekjeve tona për konsolidimin e sistemit institucional dhe për vendosjen e rendit kushtetues në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, ICO dhe Qeveria kanë hartuar Qasjen gjithëpërfshirëse të veprimeve në veri të Kosovës, e cila është mbështetur gjerësisht nga politika e institucionet tona, por edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Ka ardhur koha që në atë pjesë të Kosovës të fillojnë procese të reja integruese dhe prosperuese për të mirën e qytetarëve tanë atje, si në gjithë vendit tonë.

Ne e ftojmë Republikën e Serbisë të mbajë qëndrim konstruktiv ndaj kësaj strategjie qëllimnore, t'i kontribuojë marrëdhënieve tona të mira e integruese evropiane, proceseve paqësore dhe dialogut pragmatik për çështjet e interesit të përbashkët. Kosova e pavarur është realitet i pakthyeshem dhe integriteti i saj i garantuar ndërkombëtarisht është i pacenueshem. Komuniteti serb në Kosovë dhe komuniteti shqiptar në Serbi duhet të na shërbejnë si ura të komunikimit e të bashkëpunimit reciprok.

Ashtu siç u vlerësua para sa ditësh edhe nga Grupi Ndërkombëtar Drejtues, zbatimi i Propozimit gjithëpërfshirës për Statusin e Kosovës ka përparuar shumë, sepse institucionet tona kanë qenë përgjegjëse për zotimet e marra para bashkësisë ndërkombëtare dhe qytetarëve. Tashti që kemi një bazë solide të integritetit të brendshëm, ne do të vazhdojmë këtë proces deri në fund për të lehtësuar funksionalizimin e plotë institucional dhe integritet euroatlantike.

Zonja dhe zotërinj,

Ne qytetarët e Kosovës, pa dallim, kemi armikun e përbashkët të quajtur varfëri dhe interesin e lartë për një jetë më të mirë, më të sigurt e më të dinjitetshme. Vlera e pavarësisë së Kosovës matet në radhë të parë me përmirësimin praktik të jetës së qytetarëve. Por, ne duhet ta ndërtojmë bashkë dhe me duart tona të ardhmen tonë. Vendi ynë ndodhet në sfida të vazhdueshme si ajo e njohjes së gjerë ndërkombëtare të pavarësisë, e anëtarësimit në OKB dhe në organizata të tjera ndërkombëtare, e reformave demokratike, e përmbylljes së kornizës ligjore, e sundimit të ligjit dhe e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, e luftës kundër varfërisë dhe papunësisë, e rritjes dhe zhvillimit ekonomik, e procesit të privatizimit, e decentralizimit të plotë dhe e përkrahjes politike e financiare të komunave të reja, e integritetit të veriut dhe të gjithë serbëve në shoqërinë e Kosovës, e zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, e përmbushjes së kriterëve të liberalizimit të vizave dhe të integritetit evropian, e Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit, e përmirësimit të kapaciteteve administrative, e bashkëpunimit rajonal etj.

Kosova e ka shpallur pavarësinë dhe sovranitetin, prandaj duhet jetësuar plotësisht dhe në gjithë hapësirën e saj. Ne e miratuar Kushtetutën dhe ligjet, të cilat duhet respektuar e zbatuar rigorozisht, sepse duam shtet ligjor dhe demokratik. Ne i bëjmë institucionet, të cilat duhet forcuar e funksionalizuar, që të gëzojnë besimin dhe respektin e vazhdueshëm të qytetarëve, i bëjmë strategjitë për fusha të ndryshme, të cilat duhet t'i vëmë në jetë. Ne jemi përcaktuar qartë dhe fuqishëm për integritet euroatlantike, prandaj të gjithë, shqiptarët shumicë, komunitetet pakicë, qytetarët dhe institucionet, shoqëria civile dhe mediat, çdo ditë duhet t'i shtojmë përpara këto procese.

Në këtë përvjetor të pavarësisë i kujtojmë me pietet të rënët e të gjithë brezave, që u sakrifkuan për liri dhe për Kosovën e re që po e gëzojmë. Sot përkulemi para kujtimit të lavdishëm të flijimit biblik të komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes së tij në Epopenë e Prekazit monumental. Ne u detyrohemi atyre për jetë, por edhe amanetit që na e lanë.

Dëshiroj ta mbyll këtë fjalë me mirënjohjen e thellë dhe falënderimin e madh botës demokratike, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian, NATO-s dhe gjithë miqve tanë të shtrenjtë anekënd globit që ndihmuan Kosovën në proceset e vështira e historike të çlirimit, të vendosjes së paqes dhe të ndërtimit të demokracisë e të rimëkëmbjes pas luftës shkatërruese.

Zonja dhe zotërinj,
Qytetarë të nderuar,
Urime dyvjetori i pavarësisë së Kosovës!
Urime për të gjithë ata që dhanë kontributin për lirinë tonë dhe pavarësinë tonë!
Faleminderit!

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,
Të respektuar mysafirë dhe qytetarë,
Ftoj presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Fatmir Sejdiu për një fjalë rasti!

PRESIDENTI I KOSOVËS, FATMIR SEJDIU:

I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës, zoti Jakup Krasniqi,
I nderuar kryeministër Thaçi,
Të nderuar deputetë dhe ministra,
I nderuar Përfaqësues Civil Ndërkombëtar, zoti Peter Feith,
Zoti Kermabo,
I nderuari kongresmen Pomeroy,
Ambasadorë të akredituar në Prishtinë,
Komandant i KFOR-it, Gjeneral Markus Bentler,
Komandantë të Forcës së Sigurisë dhe të Policisë së Kosovës,
Të nderuar familje të presidentit historik, Rugova, të komandantit, Adem Jashari, dhe të dëshmorëve të rënë për liri,
Të nderuar përfaqësues të jetës arsimore, shkencore, kulturore e shpirtërore të vendit,
Të nderuar përfaqësues të mediave,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Dy vjet më parë, përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës shpallën pavarësinë e Republikës së Kosovës, e cila është rezultat i punës, i sakrificave dhe i flijimeve të gjata të brezave të shumtë të Kosovës, si dhe i ndihmës së madhe të miqve tanë

ndërkombëtarë, të vendeve të Aleancës Veriatlantike dhe të vendeve të tjera anekënd botës.

Sot, kur kremtojmë dyvjetorin e pavarësisë së shtetit tonë të lirë, ne kujtojmë me mburrje ideatorin dhe arkitektin e Republikës së Kosovës, prijësin tonë historik dr. Ibrahim Rugova, i cili përhapri të vërtetën për Kosovën në të gjitha qendrat e mëdha të botës: në Uashington, në Bruksel, në Londër, në Paris, në Berlin, në Romë, në Ankara e gjetiu.

Filozofia politike e Ibrahim Rugovës, fryma krejtësisht e veçantë e humanizmit dhe e paqes që ai predikonte ishin diçka e re për këtë pjesë të Evropës e të botës, në të cilën përherë ka mbisunduar retorika e luftës dhe e urrejtjes. Urtësia dhe largpamësia e tij, në një kohë kur Ballkani Perëndimor po kalonte nëpër kalvare të tragjedi apokaliptike, ndërgjegjësoi botën demokratike për rrezikun që i kërcënohej Kosovës dhe popullit të saj. Kjo filozofi politike dhe lufta çlirimtare e popullit të Kosovës për liri, me shembullin unik të flijimit të familjes Jashari në Prekaz të Drenicës, bindën botën për drejtësinë e kauzës sonë, e cila u përkrah fuqishëm edhe nga NATO-ja, e cila në pranverën e vitit 1999 nisi fushatën e madhe për shpëtimin e popullit të Kosovës nga gjenocidi.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Pavarësia e Kosovës është njohur nga 65 vende demokratike anekënd globit. Vendi ynë ka vendosur marrëdhënie bilaterale me shumë vende të botës. Kemi hapur 21 ambasada dhe 10 misione konsullore në vendet që na kanë njohur dhe mund të themi se, për fillim, kemi arritur të ndërtojmë një diplomaci solide, e cila po e përfaqëson me dinjitet vendin tonë në botën e jashtme.

Gjithmonë në bashkërendim të plotë me vendet tona mike, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me vendet kryesore të Bashkimit Evropian dhe me vendet e tjera mike, ne kemi punuar që të sigurojmë sa më shumë njohje, në mënyrë që Republika e Kosovës të ketë vendin e saj në kuadër të familjes së madhe të kombeve të lira. Për këtë qëllim, ne kemi zhvilluar gjatë këtyre viteve një bashkëpunim të pashkëputur me miqtë tanë, kemi lobuar te vendet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, si dhe kemi kërkuar nga vendet mike që ta përdorin influencën e tyre për ta mbështetur Kosovën në këtë proces të rëndësishëm.

Besojmë fuqishëm se frytet e këtij angazhimi nuk do të mungojnë dhe presim që njohje të reja do të vijnë me kohë, veçmas pasi që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të japë mendimin e vet për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Siç e dini, vjeshtën që shkoi, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë pati një seancë dëgjimore për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe përfaqësuesit tanë shtruan në mënyrë të qartë argumentet pro pavarësisë së Kosovës, të cilat janë të parrëzueshme. Me këtë rast, ne u shprehim sërish falënderimin tonë të gjitha vendeve që paraqitën mbështetjet e tyre me shkrim dhe mbrojtën të drejtën e popullit të Kosovës për të jetuar i lirë dhe për t'u vetëqeverisur.

Të nderuar deputetë,

Gjatë dy viteve të funksionimit tonë si shtet i pavarur ne kemi arritur të dëshmojmë faqe botës se pavarësia e Kosovës i ka sjellë më shumë paqe dhe stabilitet rajonit. Republika e Kosovës, me politikën e saj të fqinjësisë së mirë, jo vetëm që është dëshmuar si një faktor i rëndësishëm i paqes, por edhe ka shërbyer si një katalizator i marrëdhënieve më të mira në mes vendeve të rajonit. Fatmirësisht, politika jonë e fqinjësisë së mirë ka gjetur mirëkuptimin e plotë të vendeve fqinje dhe ne tashmë kemi marrëdhënie të shkëlqyeshme me Shqipërinë, me Maqedoninë, me Malin e Zi, si dhe me vendet e rajonit, me Kroacinë, me Slloveninë dhe me Bullgarinë. Ndonëse ende nuk kemi njohjen zyrtare të pavarësisë së Kosovës nga ana e shtetit grek, ne edhe me këtë vend kemi bashkëpunim intensiv dhe të shkëlqyeshëm.

Problemi ynë i vetëm në raportet me jashtë mbetet Serbia, e cila po e vazhdon politikën e saj agresive kundër Kosovës. Beogradi zyrtar po i financon strukturat paralele serbe, të cilat veprojnë në veri të vendit, ku ende kemi shkallë të lartë të kontrabandës dhe të kriminalitetit ekonomik. Qindra-miliona euro janë investuar nga Serbia për mbajtjen e këtyre strukturave, të cilat po e mbajnë peng komunitetin serb në atë pjesë të Kosovës, duke mos i lejuar qytetarët e këtij nacionaliteti të integrohen në jetën institucionale dhe shoqërore të Kosovës për të mirën e tyre dhe të mirën tonë të përbashkët.

Ne besojmë se kjo gjendje atje duhet të marrë fund, ndërsa njerëzit duhet të kenë të drejtën e tyre për t'u kthyer në shtëpitë e tyre, serbët në jug, ndërsa shqiptarët, boshnjakët dhe të tjerët në veri, atëherë ku kanë jetuar të gjithë me shekuj.

Ne e kemi përkrahur strategjinë për veriu të Qeverisë së Kosovës dhe të Zyrës së Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, e cila synon të sjellë normalitetin në këtë pjesë të vendit, në të cilën shumë vjet me radhë kanë vepruar të lirë individë e banda që i kanë shumë borxhe drejtësisë për krimet e kryera gjatë viteve të luftës në Bosnjë, në Kroaci dhe në Kosovë.

Po ashtu, mbështetje të plotë i kemi dhënë edhe përkushtimit të EULEX-it për ta ndihmuar funksionimin e rendit dhe të ligjit në Kosovë, një sferë kjo në të cilën na mbetet ende shumë punë për të bërë.

Kosovës i nevojitet një gjyqësor i pavarur, profesional, i ripërtërirë dhe i reformuar. Për ta arritur këtë, ky sistem ka nevojë për mbështetje të parazervë të institucioneve të vendit, por edhe të vetë qytetarëve, të cilët nuk duhet të ngurrojnë për të bashkëpunuar me mekanizmat që garantojnë ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit në shtetin tonë, me Policinë e Kosovës, me gjykatat e me prokuroritë. Shteti duhet të funksionojë si një tërësi, si një aparat i vetëm, në të kundërtën njerëzit që nuk duan rend e ligj, por më keq, njerëzit që duan të jenë mbi ligjin, do t'i kenë duart e lira për t'i zhvilluar veprimtaritë e tyre joligjore.

Po kështu, sfida më vete mbetet lufta për një ekonomi të lirë e të shëndetshme, e cila mbështetet në parimet e tregut të lirë. Dhe, jemi në rrugë të mirë.

Të nderuar deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Viti i tretë i pavarësisë na gjen me shumë sfida, por edhe me vizionin e qartë për të ardhmen tonë. Republika e Kosovës synim kryesor ka integrimin sa më të shpejtë në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Për jetësimin e këtij synimi duhet të jemi të përkushtuar të gjithë, pa marrë parasysh cila është detyra që kryejmë aktualisht, pa marrë parasysh cili është vendi ku ndodhemi. Secili qytetar i Kosovës e ka obligim t'i shërbejë këtij qëllimi qoftë nëse është në Kosovë, qoftë nëse ndodhet jashtë vendit. Rrjedhimisht, secili duhet ta ndiejë veten si një ambasador i Kosovës dhe të sillet, të punojë dhe të veprojë si një prezantues i Kosovës kudo që ndodhet.

Ne jemi shteti më i ri në Evropë dhe në botë. Kjo nuk është një përparësi, përkundrazi një pengesë në udhën e vështirë e me plot përgjegjësi për të ardhmen tonë. Ne na duhet të punojmë dyfish më shumë për të arritur shkallën e zhvillimit të vendeve të tjera, ne na duhet të tregohemi dyfish më të kujdesshëm në procesin e përmbushjes së standardeve të kërkuara për integrimet euroatlantike. Së këndejmi, të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se bota na shikon me llupë dhe se asnjë veprim yni nuk mbetet i paanalizuar. Punën që do ta bëjmë, do ta bëjmë punë për veten, punë edhe për miqtë tanë që kanë investuar shumë, punë për Kosovën e së ardhmes.

Sot, më 17 Shkurt, në këtë ditë të shenjtë për vendit tonë, si president, si prind dhe si qytetar i vendit, ju bëj thirrje të gjithëve që ta keni ndërmend gjithmonë kush jemi dhe ku duam të mbërrijmë. Kosova është vend i vogël, me shumë sfida. Asaj i duhet dora e zgjatur e miqve, e cila për fat asnjëherë nuk na është mohuar. Mirëpo, ne, si qytetarë, si institucione të shtetit e si njerëz që dinë të tregojnë mirënjohje për miqtë, e kemi borxh të sillemi ashtu siç e kërkon koha prej nesh, me urtësi, me guxim dhe me përgjegjësi të jashtëzakonshme.

Dikur kemi pasur një ëndërr, një vizion: Kosovën e pavarur. Sot, kemi një tjetër ëndërr, Kosovën në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Le të bëhemi të gjithë shërbyes kokulur të kësaj ëndrre, të kësaj ideje, në mënyrë që fëmijët tanë, e më pastaj fëmijët e tyre, të thonë: ja, ata, prindërit tanë, gjyshërit tanë, kishin për çfarë të jetonin, kishin çfarë të besonin.

Një komb nuk është i rrezikuar të shuhet nga robëria apo gjendja e rëndë ekonomike, por nga mungesa e ëndrrës dhe e besimit. Sa popuj të vegjël kanë mbijetuar gjatë stuhive të shekujve e sa perandori janë zhdukur si të mos ekzistonin kurrë. Madhështia e një kombi nuk matet me fuqinë e tij, por me mençurinë dhe besimin. Nëse dimë të udhëhiqemi nga këto virtyte të larta njerëzore, nuk kemi pse të frikësohemi për atdheun që do t'ua lëmë trashëgim brezave tanë të ardhshëm.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, ju uroj të gjithëve dyvjetorin e pavarësisë së Republikës sonë!

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës dhe qytetarët e saj të mrekullueshëm!

Zoti i bekoftë miqtë e Republikës së Kosovës!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Falënderoj presidentin Sejdiu për fjalën e tij dhe ftoj kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi për një fjalë rasti.

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI:

I nderuari president i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu,
 I nderuari kryetar i Parlamentit , zoti Jakup Krasniqi,
 Të nderuar deputetë, zëvendëskryeministra, të nderuar ministra,
 I nderuari z. Peter Feith,
 I nderuari kongresmen, miku im Pomeroy,
 I nderuari komandant i KFOR-it,
 Të nderuara familje Jashari dhe Rugova,
 Të nderuar dhe të dashur mysafirë,
 Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
 Zonja dhe zotërinj,

Sot ne po shënojmë një ditë, e cila është e rrënjësuar thellë në kujtesën e secilit prej nesh dhe në kujtesën tonë kolektive si popull. Sot, po shënojmë dyvjetorin e kurorëzimit të rrugëtimit tonë shekullor si popull - shpalljen e Kosovës shtet i pavarur, sovran dhe demokratik.

Për të mbërritur deri tek kjo festë e madhe e Ditës së Pavarësisë së vendit tonë, të gjithë ne së bashku punuam dhe sakrifikuam shumë gjenerata e gjenerata. Vizionin tonë të përbashkët dhe universal për liri, pavarësi dhe rend demokratik në atdheut tonë e realizuam bashkërisht me unitet të qëndrueshëm politik dhe qytetar. Pavarësia e Kosovës është meritë e çdo qytetari të Republikës së Kosovës. Çdo qytetar duhet të ndihet krenar kudo që jeton, në Kosovë dhe diasporë, si qytetarë, si familje dhe si shoqëri.

Populli i Kosovës është krijues i shtetit të Kosovës. Republika e Kosovës në dyvjetorin e shënimit të Ditës së Pavarësisë është shtet edhe më e konsoliduar, më e zhvilluar me institucionet stabile dhe efektive, me qeverisjen e mirë, sundim të rendit e të ligjit, me respektimin afirmativ të komuniteteve.

Për herë të parë në Kosovën e pavarur u organizuan zgjedhjet lokale, ku qytetarët tanë në mënyrë të dinjitetshme dhe shumë krenare zgjodhën udhëheqësit e tyre lokalë. Ishin këto zgjedhje të lira, fer dhe demokratike, që u vlerësua lart nga të gjithë.

Republika e Kosovës u bë anëtare me të drejta të barabarta në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar, ndërsa jemi afër anëtarësimit edhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Me përkushtimin tonë të vazhdueshëm institucional ne krijuam vende të reja pune me paga më të mira, ndërtuam me qindra kilometra rrugë të reja, dhjetëra shkolla të reja, bëmë reforma të rëndësishme edhe në politikë, edhe në legjislacion, edhe në ekonomi.

Jemi duke vazhduar kështu për të përmirësuar jetën e përditshme të qytetarëve duke mundësuar një të ardhme më të mirë, më të sigurt për fëmijët tanë.

Të nderuar deputetë,

Mysafir të çmuar,

Zonja dhe zotërinj,

Në këto momente të rëndësishme të shënimit të ditës sonë të madhe, ne kujtojmë të kaluarën e vendit tonë, të kaluarën e ndritshme, themelin e fuqishëm të së ardhmes sonë zhvillimore dhe prosperuese.

Në ditët si kjo, ne duhet të nderojmë dëshmorët tanë, ata që dhanë më të shtrenjtën për lirinë e vendit tonë. Po ashtu, ne duhet të nderojmë dhe të respektojmë edhe heronjtë e gjallë të këtij vendi, veteranët, ata qindra mijëra mësues të ditëve më të rënda që na mësuan ta duam atdheun dhe lirinë, mjekët që na shëruan plagët, artistët që na pasuruan shpirtin, bujqit që punuan shumë, pensionistët që gjithashtu punuan shumë. Pra, të gjithë, të gjithë kontribuan në pavarësinë që ne e kemi sot.

Prandaj, si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, falënderoj të gjitha shtetet mike, mbështetëse të përpjekjeve tona për liri dhe pavarësi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet e Bashkimit Evropian dhe gjithë mbështetësit në përpjekjet tona për liri, pavarësi, të procesit të njohjeve dhe tash në procesin integruar. Ne të gjithë së bashku ndihemi krenar që, ashtu siç edhe arritëm pavarësinë e vendit tonë, bashkërisht po punojmë çdo ditë për zhvillimin dhe integrimin e Republikës sonë në institucionet euroatlantike.

Të nderuar deputet,

Mysafirë të çmuar,

Zonja dhe zotërinj

Secili qytetar i Kosovës duhet të ndihet krenarë për kontributin tij në realizimin e këtij vizioni. Deri sa po shënojmë ditën tonë të pavarësisë, ftoj qytetarët që të festojnë me dinjitet dhe krenari, ashtu siç kemi festuar gjithëherë. Ne po ndërtojmë shtet demokratik dhe multietnik. T'i nderojmë heronjtë tanë dhe të kalojmë shumë kohë me familje tona sepse është ditë për t'u krenuar. T'u flasim fëmijëve tanë për rrugëtimet e gjata të baballarëve tanë dhe mbi të gjitha t'u flasim që të punojmë për të ardhmen. Përderisa dje sfidë kryesore e jona ishte mbijetesa, liria dhe çlirimi, pavarësia, sfidat e së ardhmes janë sfida të zhvillimit dhe të integritetit.

Kosova do të integrohet në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Derisa para dy vitesh Kosova u shpall shtet, sot Kosova ka fituar statusin evropian. Ne sot po ndërtojmë Kosovën e përjetshme, Kosovën krenare, Kosovën e së ardhmes.

Urime pavarësia të gjithëve! Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Falënderojmë kryeministrin e Republikës së Kosovës për fjalën e tij!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Zonja dhe zotërinj,

Me këtë fjalë, ne mbyllim seancën e sotme solemne për dyvjetorin e pavarësisë së Kosovës. Mirupafshim në seancë tjetër!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Republikës së Kosovës